

L I G J
Nr. 8550, datë 18.11.1999

STATUSI I DEPUTETIT

(Ndryshuar me ligjin nr. 8988, datë 24.12.2002; nr. 10160, datë 15.10.2009; nr. 153/2013, datë 30.5.2013)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I
MARRËDHËNIET JURIDIKE

Neni 1

Deputeti është përfaqësuesi i popullit në organin më të lartë ligjvënës, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Ai vepron në emër të Kushtetutës dhe të ligjeve dhe i përmbahet betimit të tij si deputet.

Neni 2

1. Deputeti i Kuvendit gëzon status të veçantë gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit të deputetit, status që buron nga Kushtetuta dhe nga ligjet.

2. Me status të deputetit kuptohet pozicioni që ka ai në marrëdhëniet juridike, në marrëdhëniet me organet administrative shtetërore dhe organet e qeverisjes vendore, si dhe të drejtat dhe detyrimet financiare dhe protokollare.

Neni 3

1. Deputeti gëzon imunitet që garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

2. Mandati i deputetit fillon, mbaron ose është i pavlefshëm kur vërtetohen kushtet e parashikuara në nenin 71 të Kushtetutës.

3. Rastet e tjera të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, përveç atyre të parashikuara në nenin 70 pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës, janë të barazvlefshme me ato të anëtarit të Këshillit të Ministrave, parashikuar nga neni 103 i Kushtetutës.

Neni 4

1. Deputeti merr pjesë rregullisht në seanca plenare, në komisione si dhe në të gjithë veprimtarinë e Kuvendit, në përputhje me kërkesat e Rregullores së Kuvendit.

2. Deputeti ka të drejtë të ushtrojë vetë dhe në kuadrin e veprimtarisë së komisionit kontrollin e zbatimit të ligjeve, vendimeve e akteve të tjera të nxjerra nga Kuvendi, nga Këshilli i Ministrave, nga ministritë, nga organet e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera qendrore.

3. Deputeti ka të drejtë të shprehë lirisht mendimet e tij dhe të zgjedhësve që ai

përfaqëson, nëpërmjet diskutimeve, propozimeve, debatit, interpelancave dhe pyetjeve, mocioneve, deklaratave dhe votës.

Neni 5

(Ndryshuar me ligjin nr. 153/2013, datë 30.5.2013)

Deputeti takohet periodikisht me zgjedhësit ose kur e kërkojnë ata. Deputeti i përfaqëson ata duke iu marrë mendime apo duke iu dhënë shpjegime për projektligje, amendamente, vendime, rezoluta apo deklarata që shqyrtohen dhe miratohen në Kuvend.

KREU II

MARRËDHËNIET ME ORGANET SHTETËRORE QENDRORE E VENDORE

Neni 6

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 153/2013, datë 30.5.2013)

1. Deputeti ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe analizat që organizohen nga organet e qeverisjes vendore.

2. Organet e qeverisjes vendore dhe prefekturat, në fillim të çdo muaji, njoftojnë deputetët e qarkut ku ata janë zgjedhur për kalendarin e mbledhjeve, duke përfshirë ndryshimet e mundshme që mund t'i bëhen atij.

Neni 7

Drejtuesit kryesorë të ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore detyrohen të presin me përparësi deputetin sa herë që ky kërkon takim për problemet që lidhen me ushtrimin e detyrës së tyre.

Neni 8

(Ndryshuar me ligjin nr. 153/2013, datë 30.5.2013)

1. Deputeti ka të drejtë të kërkojë shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrës së tij, nga ministrat ose nga drejtuesit e institucioneve të tjera qendrore, si dhe nga drejtuesit e çdo institucioni tjetër në administratën publike ose të qeverisjes vendore.

2. Drejtuesit e institucioneve të përmendura në pikën 1 të këtij neni janë të detyruar t'i përgjigjen deputetit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

3. Në rast shkeljeje të pikës 2 të këtij neni, njoftohet Kryeministri për të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse. Në rastet e enteve apo institucioneve të tjera qendrore, njoftohet organi prej të cilit ato janë zgjedhur.

Neni 9

(Ndryshuar me ligjin nr. 153/2013, datë 30.5.2013)

Deputeti ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, në ministri ose në institucione të tjera qendrore dhe vendore, kur në to shqyrtohen probleme të ngritura prej tij dhe që lidhen me qarkun ku është zgjedhur.

Neni 10

(Ndryshuar me ligjin nr. 153/2013, datë 30.5.2013)

1. Organet shtetërore dhe vendore janë të detyruara të marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat dhe propozimet e bëra nga zgjedhësit, të cilat i paraqiten atyre nëpërmjet deputetit.

2. Këto organe, brenda 1 muaji nga data e paraqitjes së tyre, detyrohen të njoftojnë deputetin për mënyrën e trajtimit apo zgjidhjes së tyre.

Neni 11

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 153/2013, datë 30.5.2013)

1. Kur deputeti konstaton se një akt normativ i Këshillit të Ministrave, ministrive, institucioneve qendrore, organeve të qeverisjes vendore ose i administratës publike është i kontestueshëm, i propozon me shkrim organit përkatës rishikimin ose shfuqizimin e tij.

2. Organet drejtuese përkatëse detyrohen të shqyrtojnë propozimin e bërë nga deputeti në mbledhjen më të afërt të radhës dhe brenda 15 ditëve njoftojnë me shkrim për përfundimin e shqyrtimit.

Neni 12

1. Deputeti, kur konstaton se nëpunës të emëruar të administratës shtetërore publike shkelin ligjet, ka të drejtë të kërkojë pranë organit përkatës marrjen e masave në përputhje me legjislacionin përkatës.

2. Titullarët e këtyre organeve janë të detyruar të shqyrtojnë menjëherë propozimet e bëra dhe brenda 30 ditëve të marrin vendimin përkatës duke njoftuar deputetin.

KREU III

MARRËDHËNIET FINANCIARE

Neni 13

(Ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 153/2013, datë 30.5.2013)

1. Në klasifikim paga e deputetit vjen menjëherë pas pagës së ministrit, paga e Kryetarit të Kuvendit menjëherë pas pagës së Presidentit të Republikës dhe ajo e zëvendëskryetarëve barazohet me zëvendëskryeministrin.

2. Paga e deputetit përbëhet nga paga për pjesëmarrjen e tij në seancë, në komisione dhe në veprimtari të tjera parlamentare.

Gjithashtu, ai gëzon të drejtën e shpërblimit për pjesëmarrje në komisione, si drejtues i Komisionit apo si drejtues i grupit parlamentar.

3. Mospjesëmarrja pa shkaqe të përligjura të deputetit në seancë, në komisione ose në veprimtari të tjera parlamentare sjell ndalesën e pjesshme të pagës ose të shpërblimit.

4. Raportet e pagës, masës së dietës, të shpërblimit, si dhe norma për transportin që përfiton deputeti, kryetari i komisionit, nënkomisionit dhe kryetari i grupit parlamentar përcaktohen me vendim të Kuvendit.

5. Mospjesëmarrja pa shkaqe të përligjura e deputetit në seancë, në komisione ose në veprimtari të tjera parlamentare sjell ndalesën e pagës ditore.

Neni 14

(Ndryshuar me ligjin nr. 8988, datë 24.12.2002; shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009)

1. Deputeti që nuk banon në qytetin e Tiranës përfiton dieta gjatë kohës që merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit, të komisioneve e mbledhjet e grupit parlamentar, ndërsa deputetët që

banojnë në Tiranë përfitojnë dieta për ditët e shërbimit jashtë Tiranës. Modalitetet e përfitimit të dietave rregullohen me vendim të Kuvendit.

2. Dieta e Kryetarit, zëvendëskryetarëve dhe deputetëve do të jetë në masën 4 për qind të pagës mujore të tyre.

3. Deputeti që shkon me shërbim jashtë shtetit nga Kuvendi përfiton dietë ditore, sipas akteve të miratuara nga Kuvendi. Në rastet kur ai caktohet të marrë pjesë në delegacionet qeveritare ose të institucioneve të tjera, shpenzimet mbulohen nga institucioni që e ka ftuar, duke përfituar dietën sipas akteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

4. Shfuqizuar.

Neni 15

Deputetit i njihet e drejta e lejes vjetore të zakonshme. Me leje të zakonshme do të kuptohet periudha ndërmjet dy sesioneve të punimeve të Kuvendit, e cila duhet të jetë jo me pak së 30 ditë.

Neni 16

1. Deputetit dhe bashkëshortes (bashkëshortit) të tij/saj u njihet e drejta e pajisjes me pasaportë diplomatike gjatë kohës së kryerjes së mandatit, si dhe 3 vjet pas mbarimit të tij.

2. Shërbimet konsullore për deputetët gjatë ushtrimit të mandatit të tyre kryhen nga stafi i Kuvendit.

3. Imuniteti diplomatik i deputetit garantohej nga shtetet e tjera sipas detyrimeve që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare.

Neni 17

Deputetit i lejohet që vetëm në një rast gjatë mandatit të tij të mos paguaj detyrim doganor për mjetet e punës, që lidhen me veprimtarinë e tij si deputet.

Neni 18

(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 8988, datë 24.12.2002; ndryshuar me ligjin nr. 153/2013, datë 30.5.2013)

1. Komisionet, grupet parlamentare dhe deputetët kanë zyrat e tyre pranë selisë së Kuvendit me stafet e tyre ndihmëse.

2. Kuvendi, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, hap në çdo rreth zyra të veçanta për deputetët e maxhorancës dhe opozitës, për çdo rast që ato kanë përfaqësim. Në rrethet ku ka përfaqësim vetëm të njërës palë hapet vetëm një zyrë.

3. Kryetari i Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, emëron në zyrat përkatëse një specialist, si rregull me arsim të lartë juridik. Kuvendi pajis zyrat me mjetet e nevojshme të punës.

4. Fondet për nevojat e mësipërme përballohen nga buxheti i Kuvendit.

Neni 19

(Ndryshuar me ligjin nr. 8988, datë 24.12.2002)

Deputeti pajiset me shërbim telefonik. Vlefëta e shpenzimeve për shërbimet e telekomunikacionit përcaktohet me vendim të Kuvendit.

Shpenzimet e mësipërme për kryetarët e grupeve parlamentare dhe të komisioneve të

përhershme parlamentare janë 20 për qind më të larta se ato të deputetit.

Neni 20

1. Deputeti përfiton të drejtën e pagesës kalimtare dhe të pensionit suplementar sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme dhe ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit” me plotësimet e mëvonshme.

2. Për sëmundjet që shfaqen gjatë ushtrimit të detyrës dhe kur personeli shëndetësor vlerëson trajtimin e tyre të specializuar, deputeti mund të dërgohet për kurim jashtë shtetit. Fondet për këtë qëllim sigurohen nga Ministria e Shëndetësisë.

3. Deputeti përfiton me përparësi të drejtën e strehimit ose i jepet kredi afatgjatë nga organet shtetërore përkatëse.

Neni 21

Deputeti përfiton falas kopje të Fletoreve Zyrtare, buletine të Kuvendit ose të institucioneve të tjera qendrore, urdhra dhe vendime të Këshillit të Ministrave, si dhe urdhëresa, vendime dhe urdhra të organeve të njësive vendore të zonës, ku është zgjedhur.

Neni 22

(Ndryshuar me ligjin nr. 8988, datë 24.12.2002)

Institucionet e administratës publike, në të cilat deputetët kanë qenë të punësuar, pas mbarimit të mandatit të deputetit dhe nëse nuk kanë arritur moshën e pensionit, janë të detyruar ta rikthejnë atë në vendin e mëparshëm të punës ose t’i ofrojnë, brenda një viti nga koha e mbarimit të mandatit, një vend tjetër pune të ngjashëm ose të përafërt me atë të mëparshmin.

Neni 23

(Shfuqizuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 153/2013, datë 30.5.2013)

Deputetit i sigurohet mbrojtje e veçantë nga organet e Ministrisë së Rendit Publik, i ruhet banesa dhe i sigurohet shoqërimi në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur ai i kërkon këto.

KREU IV MARRËDHËNIET PROTOKOLLARE

Neni 24

1. Kryetari, zëvendëskryetarët, kryetarët e grupeve parlamentare, kryetarët e komisioneve të përhershme dhe deputetët e Kuvendit kanë status të veçantë protokollar.

2. Në marrëdhëniet protokollare Kryetari i Kuvendit vjen pas Presidentit të Republikës, zëvendëskryetarët pas Kryeministrit, kryetarët e komisioneve dhe kryetarët e grupeve parlamentare barazohen në trajtimin protokollar me ministrin.

3. Deputeti përfshihet, pas ministrave, në protokollin e bashkisë, të rrethit (qarkut) dhe prefekturës, ku banon ose ku është zgjedhur.

4. Deputeti ftohet të marrë pjesë në delegacionet zyrtare, ceremonitë, pritjet dhe veprimtaritë politike, kulturore, shoqërore dhe sportive, sipas protokollit të përcaktuar në këtë nen.

Neni 25

Deputeti pajiset nga Kuvendi me dokument identifikues, që është i vlefshëm deri në mbarimin e mandatit të tij. Ky dokument zëvendëson çdo leje tjetër lëshuar nga organet shtetërore civile e ushtarake, për të hyrë në vende dhe objekte të ndryshme, me përjashtim të atyre vendeve dhe objekteve, hyrja në të cilat ndalohet me ligj.

Neni 26

Deputeti nuk i nënshtrohet kontrollit doganor. Nuk i nënshtrohen këtij kontrolli në pikat e kontrollit doganor bagazhet dhe koltë vetjake që vijnë nga jashtë shtetit në emër të deputetit.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatim të këtij ligji.

Neni 28

Të drejtat që përfitojnë deputetët nga ky ligj, nuk mund të cenohen

Neni 29

Ligji nr. 7503, datë 27.7.19991 “Për statusin e deputetit të Kuvendit Popullor”, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 30

Ky ligj hyn në fuqi në 1.1.2000.

**Shpallur me dekretin nr. 2493, datë 6.12.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**